



DIREKTORIA E PËRSJITHSHME E TATIMEVE  
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier  
Nr 16247 Fier  
Datë 17.10.2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.7349 Rregj. Them.

Data Regjistrimi 19.09.2014

Nr. 3903 Vendimit

Datë 23.10.2014

V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA  
GJYQTARE - Altina NASUFI  
GJYQTARE - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 23.10.2014 , ora 10:50 shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

**PADITËS:** Shoqëria "KEDO" shpk me seli në Lagja "16 Prilli", rruga "Leon Rei" pallati 26, ap.5, Fier.

**I PADITUR:** Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.  
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

**OBJEKTI:** Anullimin e akteve administrative me nr. 11922/3, datë 18.07.2013 me objekt "refuzim të ankimit si të pa pranueshëm dhe jo objekt ankimi" si dhe kundërshtimin pjesor të aktit, njoftim vlerësimi tatimor me nr. 3893/7, datë 20.05.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 109/1, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin e saj nr. 522, datë 15.04.2014 ka vendosur:

1. *“Pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në prova e në ligj.*
2. *Anullimin e akteve administrative me nr. 11922/3, datë 18.07.2013 me objekt “Refuzim të ankimit si të papranueshëm dhe jo objekt ankimi.*
3. *Ndryshimin e detyrimit që paditësi i ka Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier e konkretisht shuma që mbetet për likuidim nga akt vlerësimi 3893/7 datë 20.05.2013 prej 974308 lekë mbështetur në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” neni 75/1 dhe udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 duhet të bëhet dhe shlyerje diferencës së detyrimit prej 331830 lekë (974308 lekë-642478 lekë) të bëhet kompensim me tepricën kreditore të TVSH-së (që është aktualisht mbi 9.000.000 lekë) në marrëveshje me DRT Fier siç është bërë dhe pjesa e detyrimit pa gjoba në datën 10.06.2013 për 642478 lekë kur është bërë dhe ankimi në DAT Tiranë.*
4. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurve solidarisht.*
5. *Urdhërohet zyra e përmbarimit me ekzekutimin e këtij vendimi nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.*
6. *Ndaj këtij vendimi nuk nxirret urdhër ekzekutimi.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (DRT Fier) në datën 09.06.2014 duke parashtruar shkaqet për ndryshimin e tij si më poshtë vijon:

1. *Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është i pabazuar në ligj e në prova.*
2. *Ndaj paditësit është ushtruar kontroll në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 7928/1995 dhe ligjit nr. 9920/2008 si dhe kërkesat e ligjit nr. 9136/2003 si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave “Për mbledhjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.*
3. *Në zbatim të këtij kontrollit ka dalë dhe njoftim vlerësimi me detyrimet për subjektin në vlerën 1.547.238 lekë.*
4. *Paditësi ka paraqitur observacionet e tij në DRT Fier dhe DRT Fier e ka sqaruar paditësin në lidhje me pretendimet e tij se shitjet e vitit 2011 për artikullin “gaz Freon” të paraqitura në akt-kontroll janë të sakta dhe të rakorduara me vlerën e deklarimeve tuaja në sistem.*
5. *Në lidhje me pretendimet se administratori përfiton dividend dhe nuk ka marrë pagë, rezulton se administratori nuk ka përfituar nga shpërndarja e dividendit dhe as nuk ka përfituar pagë.*
6. *Në lidhje me pretendimin për gjendjen e tepricës kreditore të datës 28.02.2013 rezulton se pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë pasi sipas sistemit informatik rezulton se gjendja e tepricës kreditore në këtë datë është në shumën 7.046.735 lekë.*

7. *Drejtoria Rajonale Tatimore Fier i konsideron të ligjshme aktet administrative objekt ankimi.*

Sa më sipër pala e paditur DRT Fier kërkon ndryshimin e vendimit nr. 522, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj e në prova.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe pasi analizoi shkaqet e ngritura në ankim, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

**VËREN**

Se çështja objekt gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit është Vendimi nr. 522, datë 15.04.2014, i Gjykatës Administrative e Shkallës Parë Vlorë, me anë të të cilit është shqyrtuar dhe disponuar në lidhje me kërkesën padinë e paditësit Shoqëria "KEDO" shpk, me objekt, bazë ligjore dhe palë të paditur siç përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Pala e paditur DRT Fier ka kundërshtuar vendimin nr. 522, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për shkaqet sa më sipër.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala e paditur DRT Fier është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi janë verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tij, sipas neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 "*Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative*" e për rrjedhojë është i shoqëruar me vendimin e gjyqtarit, që ka disponuar në lidhje me pranimin e këtij ankimi.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

***Rrethanat e çështjes***

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 522, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

Shoqëria "KEDO" shpk është një person juridik privat i rregjistruar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar që ushtron aktivitet me objekt: "Në fushën e tregtimit me shumicë dhe pakicë, improtimit, eksportimit, prodhimit të të gjitha llojeve të mallrave ushqimore dhe industriale, etj." me seli të regjistruar në qytetin e Fierit.

Pala e paditur ka ushtruar kontroll pranë palës së paditur dhe në përfundim të kontrollit ka nxjerrë akt-kontrollin nr. 3893/4, datë 10.05.2013. Në vijim pala e paditur pasi ka shqyrtuar dhe observacionet e shoqërisë paditëse ka nxjerrë aktin administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 3893/7 Prot. Datë 20.05.2013 duke e shpallur palën paditëse debitore për detyrime të papaguara në shumën 1.547.238 lekë, si dhe e ka informuar në lidhje me të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor brenda 30 ditëve.

Shoqëria paditëse i është drejtuar Drejtorisë së Apelitit Tatimor me ankimin administrativ me objekt "Ankim i aktit administrativ Njoftim dhe kërkesë për tu paguar nr. 7234, datë 21.06.2013, lëshuar nga DRT Fier".

DAT Tiranë i ka kërkuar paditësit të plotësojë dokumentacionin pasi mungon akti administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet sipas raport kontrollit tatimor. Paditësi ka plotësuar dokumentacionin duke i dërguar DAT Tiranë aktin "Njoftim dhe kërkesë për tu paguar nr. 7234, datë 21.06.2013, të DRT Fier".

DAT Tiranë ka shqyrtuar dokumentacioni dhe me vendimin nr. 11921/3 Prot. Datë 18.07.2013 ka vendosur të "Të refuzojë ankimin për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm, pasi Njoftim dhe kërkesë për tu paguar nr. 7234, datë 21.06.2013 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier, nuk është objekt i ankimit administrative tatimor". Këtë vendim DAT e ka mbështetur në nenin 106.1.3/c të udhëzimit nr. 24 dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Në këtë dipozitivë përcaktohet se: "*aktet e administrative që lidhen me mbledhjen e detyrimeve nuk mund të jetë objekt apelimi*".

Në këto rrethana shoqëria paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë padi, duke kërkuar anulimin e akteve administrative me nr. 11922/3, datë 18.07.2013 me objekt "refuzim të ankimit si të pa pranueshëm dhe jo objekt ankimi" si dhe kundërshtimin pjesor të aktit, njoftim vlerësimi tatimor me nr. 3893/7, datë 20.05.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Këtë kërkim paditësi e ka referuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 109/1, ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendimin nr. 158, datë 20.01.2014 ka vendosur të deklarojë mungesën e kompetencës lëndore për gjykimin e kësaj çështje dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë si gjykata kompetente.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në përfundim të shqyrtimit të çështjes me vendimin e saj nr. 522, datë 15.04.2014 ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë "KEDO" shpk si të bazuar në prova e në ligj.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 522, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

1. Gjykata çmon se nga shuma e detyrimit të përcaktuar në njoftim vlerësimin tatimor prej 1.547.238 lekë në total pranohen 974.308 lekë dhe refuzohen 572. 930 lekë. Shuma që refuzohet përbëhet nga gjoba TF për pagën e administratorit 71075 për vitet 2007, 2009, 2010, 2011, nga TVSH për diferencë çmimi të 332 copë gaz Freon për vitin 2011 del

- tepër nga bilanci material në shumën 21338, nga gjoba TF llogaritur tepër nga shpenzimet materiale për vitin 2010 dhe gabime llogaritje 96841 lek dhe nga gjoba TF llogaritur tepër për vitin 2010 lek 139137.
2. Gjykata çmon se nga kamatë vonesa TF viti 2009, 2010 lek 128.414, gjobë aplikuar për TF prej 25% për pagën e administratorit që është pronar i vetëm dhe paga nuk është derdhur në Bankë bie në kundërshtim me ligjin nr. 8438/1998 neni 21 gërma "n" që përcakton se paga që nuk ka kaluar në sistemin banker nuk quhet shpenzim i njohur.
  3. Shpenzimet për pagat në çdo rast nuk janë furnizim i tatuëshëm me TVSH dhe aplikimi i TVSH-së mbi pagën është në kundërshtim me ligjin nr. 7928/1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".
  4. Gjykata çmon se duhet të zbritet kamatëvonesa prej 128.414 lekë për TF viti 2009 dhe 2010 mbasi nuk mund të llogaritet kamatë për detyrime që nuk ekzistojnë.
  5. Në përfundim të analizimit të provave, gjykata çmon se shuma që mbetet për likuidim nga akt vlerësimi 3893/7, datë 20.05.2013 prej 974.308 lekë mbështetur në ligjin nr. 9920/2008 neni 75/1 duhet të bëhet shlyerje e diferencës së detyrimit prej 331830 lekë të bëhet me kompensim me tepricën kreditore të TVSH-së në marrëveshje me DRT Fier, siç është bërë edhe pjesa e detyrimit pa gjoba në datën 10.06.2013 për 642.478 lekë kur është bërë dhe ankimimi në DAT Tiranë.

Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka bërë ankim pala e paditur DRT Fier për shkaqet e paraqitura në pjesën hyrëse të këtij vendimi duke kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë së palës paditëse si të pabazuar në ligj e në prova.

#### *Vlerësimi i gjykatës*

Në analizë të vendimit nr. 522, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, të pretendimeve të ngritura në ankim, të akteve të dosjes si dhe të përcaktimeve të ligjit, gjykata çmon se: vendimi nr. 522, datë 15.04.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duhet të priset dhe gjykimi i çështjes duhet të pushohet, për shkak se jemi para një padie që nuk mund të ngrihet.

Rezulton se pala e paditur nëpërmjet padisë së saj kundërshton aktin administrativ me nr. 11922/3, datë 18.07.2013 me objekt "refuzim të ankimit si të pa pranueshëm dhe jo objekt ankimi" si dhe kundërshtimin pjesor të aktit, njoftim vlerësimi tatimor me nr. 3893/7, datë 20.05.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) Fier.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se njoftim vlerësimi tatimor nr. 3893/7, datë 20.05.2013 nëpërmjet të cilit DRT Fier ka njoftuar shoqërinë paditëse se ka detyrime të papaguara dhe gjoba në shumën totale prej 1.547.238 lekë nuk është ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë. Si rezultat i këtij fakti, rezulton që DRT Fier ka nxjerrë "njoftim dhe kërkesë

për tu paguar nr. 7234 lëshuar nga DRT Fier. Nga këto rrethana rezulton se paditësi nuk e ka kundërshtuar në rrugë administrative Njoftim vlerësimin tatimor nr. 3893/7 datë 20.05.2013, akt të cilin e ka goditur nëpërmjet padisë objekt gjykimi.

Ligji nr. 9920/2008 në nenin 106 të tij përcakton se:

*“Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.*

2. *Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrisë të Financave.*

3. *Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpagues.*

*4...”*

Në nenin 106.1.3/c të udhëzimit nr. 24 dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë dispozitë përcaktohet se: *“aktet e administrative që lidhen me mbledhjen e detyrimeve nuk mund të jetë objekt apelimi”*. Në kuptim të kësaj dispozite, rezulton se paditësi ka bërë objekt apelimi një akt i cili në kuptim të ligjit nuk mund të apelohej. Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vepruar drejt në kushtet në të cilat e ka refuzuar ankimin e bërë ndaj këtij akti i cili rezulton të jetë akt që lidhet me mbledhjen e detyrimit tatimor.

Ndërsa neni 109 i po këtij ligji ndër të tjera përcakton se:

*“Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dëgjimi për këtë vendim. Nëse drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë”*.

Për sa më sipër ligji nr. 9920 përcakton detyrimin e tatimpaguesit për të shteruar rrugën administrative të ankimit përpara se t'i drejtohet gjykatës për kundërshtimin e një njoftim vlerësimi që përcakton detyrime tatimore për të.

Në rastin konkret shoqëria paditëse ka ankimuar në Drejtorinë e Apelimit Tatimor aktin “Njoftim dhe kërkesë për t'u paguar” nr. 7234, datë 21.06.2013 të DRT Fier dhe jo aktin administrativ njoftim vlerësimi tatimor me nr. 3893/7, datë 20.05.2013, duke mos shteruar në këtë mënyrë rrugën administrative të ankimit.

Në lidhje me kërkimin tjetër të shoqërisë paditëse për anulimin e aktit nr. 11922/3, datë 18.07.2013 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor rezulton se kjo e fundit e ka refuzuar ankimin pasi e konsideron të papranueshëm, pasi “akti administrative që lidhet me mbledhjen e detyrimeve nuk mund të jetë objekt apelimi”. Në këtë rast shoqëria paditëse nuk ka goditur aktin administrativ i cili ka krijuar detyrime ndaj saj, por ka goditur refuzimin e ankimit nga drejtoria

e apelimit tatimor të shoqërisë ndaj këtij akti me argumentimin se ka paguar detyrimet tatimore duke paraqitur kërkesë pranë DRT Fier për kompensimin e detyrimeve me tepricat kreditore që ka shoqëria në sistemin informatik tatimor.

Gjithashtu në lidhje me këtë kërkim Gjykata çmon se paditësit i janë drejtuar gjykatës pa shteruar rrugën administrative të ankimit, pasi rezulton se ky kërkim i paditësit është bërë subjekt i masave shtrënguese të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar.

Në nenin 16 të ligjit nr. 49/2012 përcaktohet se:

*“Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ”.*

Në interpretim dispozitave sipërciatuara, Gjykata vlerëson se padia ndaj veprimeve të organit administrativ nuk mund të ngrihet pa u kundërshtuar këto akte së pari në rrugë administrative sipas parashikimeve të bëra në ligjin e posaçëm (Kreu XIII i ligjit Nr. 9920/2008).

Në këto rrethana, për sa u përshkrua më lart, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma “d” të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 *“Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”* çmon se: Vendimi nr. 522, datë 15.04.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet të priset dhe gjykimi i kësaj çështje duhet të pushohet.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma “d” të ligjit Nr. 49/2012 *“Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”*,

#### VENDOSI

1. Prishjen e vendimit nr. 522, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Pushimin e gjykimin të çështjes.
3. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
4. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 23.10.2014

GJYQTARE  
Altina NASUFI  
d.v

GJYQTARE  
Rilinda SELIMI  
d.v

GJYQTAR  
Kastriot SELITA  
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin  
KANCELAR  
Leonard STRATAJ